

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar 06 -02- 2024 Priljeno		
Numri sender Redni broj	Ças e pranimit Ças prijema	Numri i pritendit Potpis primaoca
217		



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor  
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtinë / Basic Prosecution  
Prishtinë

# RAPORTI VJETOR I PUNËS 2023

Dhjetor 2023



## Tabela e përmbatjes

1.	Fjala Hyrëse e Kryeprokurorit.....	5
2.	Prokuroria Themelore Prishtine – mandati ligjor dhe struktura organizative .....	6
2.1	Administrata.....	7
2.2	Organogrami i Prokurorisë Themelore në Prishtinë.....	8
3.	Aktivitet e Kryeprokurorit .....	9
4.	Prioritetet .....	11
5.	Sfidat.....	12
6.	Të arriturat .....	13
7.	Statistikat e përgjithshme për vitin 2023 .....	15
7.1.	Pasqyra e përgjithshme e lëndëve.....	15
7.2.	Mënyra e zgjidhjes së lëndëve (sipas personave) .....	17
7.3.	Vendimet e Gjykatës (sipas personave madhor) .....	17
7.4.	Të dhëna krahasuese për periudhën 2013-2023 .....	18
7.5.	Të dhënat statistikore sipas departamenteve.....	19
7.5.1.	Departamenti i Krimeve të Rënda .....	19
7.5.2.	Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.....	21
7.5.3.	Departamenti për të Mitur .....	22
7.5.4.	Departamenti i Përgjithshëm .....	23
7.6.	Procedura e ndërmjetësimit .....	24
7.7.	Pezullimi i përkohshëm i procedurës .....	24
7.8.	Negocimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë.....	24
8.	Konfiskimet dhe Sekuestrimet .....	24
9.	Financat dhe shpenzimet .....	25
10.	Vlerësimi i performancës së prokurorëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
11.	Komunikimi me publikun .....	25
11.1.1.	Raporti 24 orësh.....	26
11.1.2.	Kërkesat për informata .....	26
11.1.3.	Komunikatat/njoftimet/reagimet .....	26
11.1.4.	Prononcimet.....	27
11.1.5.	Kërkesat për Qasje në Dokumentë Publike.....	27
11.1.6.	Rrjetet sociale.....	27

11.2. Sfidat në fushën e komunikimit .....	27
11.3. Raporti për vitin 2023.....	28
12. Kërkesat për fillim të procedurave disiplinore për prokurorët dhe trajtimi i tyre.....	28
13. Administrata e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Struktura organizative.....	29
13.1. Administratori .....	30
13.1.1. Aktivitetet.....	30
13.2. Sektori i Shkrimes.....	30
13.2.1. Aktivitetet kryesore.....	30
13.2.2. Regjistrimi dhe ndarja automatike e lëndëve .....	31
13.2.3. Zhvillimet aktuale lidhur me zbatimin e Projektit TIK/SMIL.....	31
13.2.4. Prioritetet, sfidat, të arriturat në Sektorin e Shkrimes .....	32
13.3. Personeli profesional dhe administrativ .....	33
14. Përfundim.....	36

---

# 1. FJALA HYRËSE E KRYEPROKURORIT



Me kënaqësi ju drejtohem përmes këtij raporti vjetor të punës, me të cilin pasqyrohen rezultatet dhe aktivitetet kryesore të realizuara në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Ky raport paraqet sfidat me të cilat jemi përballur, arritjet tona përgjatë vitit 2023 si dhe prioritetet nga të cilat jemi udhëhequr.

Parimet kryesore mbi bazën e të cilave kemi zhvilluar punën tonë ishin: pavarësia; paanshmëria dhe barazia; profesionalizmi; efikasiteti; llogaridhënia dhe transparenca me publikun.

Prioritetet kryesore mbi bazën e të cilave jemi fokusuar në punën tonë ishin: ndjekja e personave të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, luftimi i krimeve ekonomike dhe korrupsionit, shtimi i efikasitetit në punë si dhe ngritja e profesionalizmit në punën e përditshme, trajtimi me prioritet të rasteve të Dhunës në Familje, Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe të Miturve, promovimin e aplikimit të procedurave alternative si dhe ngritja e resurseve humane.

Në cilësinë e Kryeprokurorit kam ndërmarrë një sërë aktivitetesh që synojnë përmirësimin e punës së prokurorisë në të gjitha segmentet e specifikuar. Veçanërisht theksoj aktivitetet në fushën e specializimit dhe metodologji të reja të punës, bashkëpunim efikas me organet e tjera shtetërore, fuqizim bashkëpunimin ndërkombëtar dhe forcimin e kapaciteteve të prokurorisë përmes përmirësimit të kualitetit të hetimeve dhe ndjekjes duke përdorur teknika dhe praktika të avancuara në pajtim me ato të vendeve më të zhvilluara të botës në luftën kundër korrupsionit. Viti 2023 ka qenë një periudhë shumë sfiduese për institucionin tonë, për shkak të disa vështirësive me të cilat jemi ballafaquar e përkundër insistimit tonë për të ndryshuar gjendjen sidomos në gjashtë (6) mujorin e parë të këtij viti. Kushtet e vështira në Pallatin e Drejtësisë kanë qenë një sfidë e vërtet e cila na vështirësuar tej mase procesin e punës si thuajse çdo javë ndonjë nga prokurorët ose stafi kishte probleme shëndetësore si pasojë e këtyre kushteve.

Kjo sfidë është tejkaluar pas insistimit tim të madh dhe adresimit të vazhdueshëm në drejtim të hapjes së dritareve dhe ajrosjes së hapësirave të Pallatit.

Megjithatë sfidat e lartpërmendura, dhe kushtet në të cilat kemi punuar, konsideroj që të arriturat që pasqyrohen përmes këtij raporti janë konkrete dhe të prekshme. Trajtimi me fokus i lëndëve të natyrës Dhunë në familje, veprat penale kundër integritet seksual, luftimi i krimeve ekonomike dhe korrupsionit, promovimi dhe aplikimi i procedurave alternative, ishin vetëm disa nga të arriturat më konkrete në këtë periudhë.

Në aspektin statistikor, raporti vjetor i punës është hartuar me qëllim që të ofroj informata mbi këto baza: pasqyrën e përgjithshme të lëndëve, statistika të veçanta sipas departamenteve dhe njësive të specializuara; mënyrën e zgjidhjes në lëndëve; rezultatet/vendimet e gjykatës; të dhëna specifike për punën në Sektorin e Shkrimores etj.

Për fund dua që të falënderoj të gjithë akterët, si Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Këshillin Prokurorial, prokurorët, stafin mbështetës, partnerët e ndryshëm ndërkombëtar, që kanë ofruar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në arritjen e objektivave të Prokurorisë Themelore Prishtinë.

Kulltim Muminishi

Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore Prishtinë

## 2. PROKURORIA THEMELORE PRISHTINE – MANDATI LIGJOR DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE

Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme.

Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat pavarësisht dallimeve të tyre.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka juridiksion për të trajtuar lëndët në shkallë të parë, për territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;<sup>1</sup>

Bazuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit, prokuroritë themelore në Republikën e Kosovës kanë këtë strukturë organizative:<sup>2</sup>

- Kryeprokurori si udhëheqësi më i lartë i institucionit;
- Departamenti i krimeve të rënda,
- Departamenti për të mitur,
- Departamenti i përgjithshëm,

Prokuroria Themelore Prishtinë ka një strukturë më specifike në raport me prokuroritë tjera themelore, meqë janë themeluar dy njësite të veçanta, të cilat trajtojnë lëndë të natyrës më specifike, dhe atë:

- **Njësi për Krime ekonomike dhe korrupsion;**
- **Njësi për trajtimin e rasteve të Dhunës në familje;**

Numri aktual i prokurorëve të angazhuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë në total është 51 dhe atë në përbërje prej:

- Kryeprokurori----- 1 pozitë
- Departamenti i Krimeve të Rënda ----- 15 prokurorë;
- Departamenti për të Mitur ----- 4 prokurorë;
- Departamenti i Përgjithshëm ----- 31 prokurorë

<sup>1</sup> Neni 3 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit

<sup>2</sup> Neni 15 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit

<sup>3</sup> Neni 14 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit

## 2.1 ADMINISTRATA

Administrata në Prokurorin e Shtetit ka për funksion ofrimin e mbështetjes teknike- administrative në punën e institucionit të Prokurorit të Shtetit..

Mbështetur në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Prokurorit të Shtetit, Administrata ka këtë strukturë organizative:<sup>3</sup>


- Administrator/e;
- Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores;
- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim profesional;
- Zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave;
- Zyrtar ligjor;
- Zyrtar për buxhet dhe financa;
- Sekretare Juridike;
- Referent i Lartë;
- Zyrtar i arkivës;
- Zyrtar për përkthim;
- Zyrtar i IT-së;
- Zyrtar për distribuimin e shkresave;
- Zyrtar për transport;
- Receptionsist;
- Zyrtar teknik i kontrollit dhe mirëmbajtës;
- Asistent për shërbime të sigurisë ;

Numri i përgjithshëm i stafit mbështetës në Prokurorin Themelore Prishtinë është si më poshtë:

- Administrator/e -----	1 pozitë
- Udhëheqës/e i Sektorit të Shkrimores-----	1 pozitë
- Bashkëpunëtor profesional-----	37 pozita
- Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave-----	1 pozitë
- Zyrtar ligjor-----	44 pozita + 1 (Zyra ndërmjetësimi)
- Zyrtar financiar-----	2 pozita
- Sekretare Juridike-----	9 pozita
- Referent-----	15 pozita + 1 (Zyra ndërmjetësimi)
- Arkivist-----	6 pozita
- Zyrtar/e për ndërmjetësim-----	0 pozitë
- Përkthyes shqip-serbisht, anasjelltas-----	3 pozita
- Zyrtar i TI-së-----	2 pozita
- Zyrtar për distribuimin e shkresave -----	3 pozita
- Zyrtar për transport -----	5 pozita
- Receptionsist-----	2 pozitë
- Mirëmbajtës (Shtëpiak)-----	1 pozitë

<sup>3</sup> Rregulloja për Organizimin e Brendshëm të Prokurorit të Shtetit

## 2.2 ORGANOGRAMI I PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË





### 3. AKTIVITET E KRYEPROKURORIT

---

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë fokus kryesor e ka pasur shtimin e resurseve humane si për prokuror në të tria (3) Departamentet ashtu edhe për staf mbështetës.

Fokus i veçantë i Kryeprokurorit ka qenë edhe krijimi i raporteve të reja me Agjencione dhe Komisione të ndryshme si vendore ashtu edhe ndërkombëtare në drejtim të rritjes së efikasitetit në luftim të krimit si dhe mbajtja e raporteve të mira ekzistuese.

Kryeprokurori prioritet dhe rëndësi i ka kushtuar edhe thellimit të bashkëpunimit me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, ku janë zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, të cilat janë çdo herë pjesë përbërëse e ditës/javës së Kryeprokurorit.

Aktivitetet kryesore në të cila Kryeprokurori ka marrë pjesë gjatë vitit 2023 janë:

- Trajnimi i organizuar nga Ambasada Amerikane në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë me temë “Risit e Kodit të Procedurës Penale”.
- Aktivitetin e Analizimit të Rasteve të Krimit të Organizuara me Institucionet e Drejtësisë, Policinë e Kosovës i organizuar nga “EBROLI”.
- Tryeza e përbashkët me Policinë e Kosovës e organizuar nga Kryeprokurori dhe z. Fehmi Hoti.
- Takim me Kryeshafen e Telekomit të Kosovës znj. Burbuqe Hana rreth trajtimit të rasteve të iniciuara nga Telekomit i Kosovës.
- Takimi i përbashkët i Kryeprokurorëve dhe Kryetarëve të Gjykatave organizuar nga EUKOJUST.
- Misioni vlerësues i Komisionit Evropian për procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Takim me përfaqësues të International Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL).
- Takim me Fehmi Gjata, shëf i hetimeve rajonale të policisë.
- Takim me Dave Eells nga EUKOJUST.
- Takim me Isa Dakaj, dhe Avdi Krasniqi nga API.
- Takim me përfaqësues të ACRO Police..
- Takim me përfaqësuesin nga Ambasada Amerikane Erin Cox si dhe Njësi për Korrupsion dhe Krime Ekonomike
- Takim me Acro Police Team
- Takim me drejtorin ekzekutiv të AKP z. Arben Limani
- Gjatë kësaj jave kryeprokurori ka qenë në udhëtim zyrtar në Vjenë.
- Takim me përfaqësues të UNDP
- Punëtori për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime për vitin 2024, të organizuar nga Akademia e Drejtësisë në mbështetje të OPDAT përkatësisht Ambasadës Amerikane
- Takim me kryetarin e Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama dhe drejtorin Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë z. Lulzim Fushtica, si dhe drejtorin e Drejtorisë së Policisë për Rajonin e Prishtinës, nënkolonel Basri Shabani


- Takim me përfaqësues të Ambasadës Amerikane
- Takim me përfaqësues të EULEX Vesa Satamo
- Takim me përfaqësues të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovë
- Takim me përfaqësues të Ambasadës Amerikane
- Pjesëmarrje në Modulin e dytë të trajnimit lidhur me luftimin e financimit të terrorizmit, të organizuar nga OSCE
- Udhëtim zyrtar në SHBA
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP/SAEK, me temën “Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve”
- Takim me përfaqësuesin nga Ambasada Amerikane Erin Cox
- Pjesëmarrja në punëtorinë “Prezantimi i Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit të Kosovës”
- Takim me përfaqësuesit e Qendrës së Automjeteve të Kosovës “Eurolab”
- Takim me Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me prokuroren përgjegjëse nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për monitorimin e punës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, znj. Laura Pula, si dhe Udhëheqësit e Departamenteve dhe Prokurorët pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
- Pjesëmarrje në punëtorinë për Hartimin e Programit Trajnues për vitin 2024
- Pjesëmarrja në “Ditët e Gjyqësorit”, të organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe e mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE)
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë “Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve”
- Organizimi i Javës së Viktimave të Krimit.
- Pjesëmarrje në takimin e kolegjiut të U.D Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e prokurorive dhe prokurorët e ZKPSH-së.

Në vazhden e takimeve dhe aktiviteteve të Kryeprokurorit, vlen të theksohet se Kryeprokurori ka pritur në vazhdimësi palë në takim për të i dëgjuar shqetësimet e tyre si dhe çdo dy javë ka mbajtur kolegjiute në tri (3) departamentet.

## 4. PRIORITETET

Krahas trajnimit të të gjitha lëndëve të cilat prokurorët i kanë në punë, disa lëndë për nga natyra janë më specifike dhe kërkojnë trajtim më me prioritet. Në këtë drejtim, lëndët që janë trajtuar më me prioritet janë:

- **lëndët me paraburgim dhe masat tjera të sigurisë së prezencës së të pandehurit në procedurë-** për shkak të afateve ligjore, këto lëndë kërkojnë veprime të shpejta dhe efikase me qëllim të respektimit të afateve, të cilat janë të përcaktuara si të tilla, me qëllim të respektimit të të drejtave të personave të cilët janë në këto masa. Në këtë drejtim, gjithnjë kur kemi situata të tilla, i gjithë stafi i Prokurorisë, përfshirë prokurorët dhe administratën dhe veprojnë me urgjencë
- **lëndët në Njësitin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit-** për shkak të natyrës specifike të këtyre lëndëve, dhe rëndësisë që ato të trajtohen në afate sa më të shpejta, prokurorët e angazhuar në Njësitin e Krimeve Ekonomike, janë të përkushtuar që të zhvillojnë procedurat në kohë sa më reale dhe në këtë mënyrë të mundësohet luftimi efikas i dukurive negative, të kësaj natyre.
- **lëndët në Departamentin për të Mitur-** në rastet kur të miturit bien ndesh me ligjin, dhe janë pjesë e proceseve pranë organeve të rendit, ato janë të obliguara të veprojnë me urgjencë në mënyrë që të respektohen të drejtat e të miturve të cilat i gëzojnë me akte vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, kur të miturit janë pjesë e proceseve në Prokurori, prokurorët e angazhuar në këtë departament, janë të angazhuar që të respektohen afatet ligjore, të drejtat e dhe interesi me i mirë i të miturve.
- **lëndët e dhunës në familje-** duke marr për bazë rëndësinë që ka familja në shoqëri, dhe situatat e tensionuara mes anëtarëve të familjes, në rastet e dhunës në familje, institucionet, e në këtë rast edhe Prokuroria janë të obliguara të ndërmarrin veprime të shpejta dhe të kujdesshme, në mënyrë që të parandalohen pasojat e më tejme. Në këtë drejtim, Prokuroria Themelore Prishtinë ka krijuar Njësitë të veçantë për trajtimin e këtyre rasteve, duke profilizuar në këtë formë prokurorët në këtë fushë.
- **lëndët e natyrës Trafikim me Qenie Njerëzore-** kjo natyrë e lëndëve konsiderohet mjaft specifike, si në aspektin e dukurisë që ndodh, po ashtu edhe në aspektin e trajtimit dhe hetimit suksesshëm të këtyre rasteve. Mbështetur në faktin që kjo natyrë e veprave penale cenon rëndë të drejtat themelore të njeriut dhe të mirat bazë të shoqërisë, të garantuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të ndryshme ndërkombëtare, prokurorët i kanë kushtuar një kujdes të veçantë trajtimit të veprave të kësaj natyre.



- **promovimi dhe aplikimi i procedurave alternative**- procedura këto të përcaktuara me ligj, të cilat janë një mundësi shumë e mirë për palët në procedurë penale të shfrytëzojnë këto të drejta që iu garantohen me ligj. Në periudhën raportuese, janë promovuar dhe nxitur prokurorët që të shfityrojnë këto procedura dhe të zgjedhin rastet me aplikim të procedurave alternative, me fokus të veçantë në procedurën e ndërmjetësimit.
- **lëndët me sekuestrim dhe konfiskim** – procedurë kjo e cila pothuajse në çdo kolegjum, pothuajse në çdo takim është e temë e cila nuk mungon asnjëherë. Edhe pse si prokurori kemi arritur progres të mirë lidhur me avancimin e procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit, për ne edhe më tutje kjo procedurë mbetet një prioritet dhe nevojë që të aplikohet edhe më shumë.
- **rritja e numrit të prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional**- duke e parë parasysh numrin e madh të prokurorëve, numrin e rasteve të pranuar, vëllimi i lëndëve më të ndjeshme, e kemi vlerësuar të nevojshme të rritim numrit të prokurorëve dhe e bashkëpunëtorëve profesional, në mënyrë që të rritet efikasiteti në trajtim të rasteve të natyrave të ndryshme, me fokus në lëndët e trajtuara nga Njësiti për Dhunë në Familje dhe Njësiti për trajtimin e rasteve të Korrupsionit.
- **lëndët e natyrës kundër integritetit seksual**- natyra e këtyre lëndëve është shprehur në rritje në këtë periudhë. Mbështetur në faktin që natyra e lëndëve të kësaj natyre është e ndieshme për viktimat dhe shoqërinë, Prokuroria ka trajtuar me fokus dhe prioritet lëndët e kësaj natyre.

## 5. SFIDAT

Përveç rezultateve të arritura, Prokuroria Themelore në Prishtinë është ballafaquar me sfida të ndryshme. Këto sfida konsiderohet që janë kaluar me sukses, për shkak se në vazhdimësi është punuar në drejtim të tejkallimit të tyre dhe në gjetjen e metodave të reja për përmirësimin e procesit të tyre. Ndër të tjera, sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Prokuroria gjatë vitit 2023 janë;



- ✓ Trajtimi i lëndëve të natyrës krime ekonomike dhe korrupsion;
- ✓ Numri i madh i lëndëve të pranuar, duke përfshirë të gjitha natyrat;
- ✓ Numri i vogël i prokurorëve në të tri departamentet si pasojë e avancimeve, pensionimeve dhe lëvizjeve brenda sistemit;



- ✓ Ngecja në realizimin e kërkesave të Kryeprokurorit për përmirësimin e procesit të punës nga ana e KPK-së;
- ✓ Pabarazia e ndarjes së lëndëve përmes sistemit SMIL si dhe ngecja e prokurorëve në përdorimin e tij;
- ✓ Numri i madh i lëndëve të natyrës PPP (kryes të panjohur) dhe trajtimi i tyre;
- ✓ Ngritja e nivelit të sigurisë brenda objektit të Prokurorisë;
- ✓ Menaxhimi i procesit të punës në Sektorin e Shkrimores, mbështetur në ngarkesën e krijuar si pasojë e mungesës së mjaftueshme të stafit;
- ✓ Vonesa në realizimin e procesit të hapjes së dritareve në objektin C;
- ✓ Mosfunksionimi konstant i sistemit të ventilimit, klimatizimit dhe ngrohjes në objektin C;
- ✓ Ndëshkueshmëria e ulët nga Gjykata për kryesit e veprave të korrupsionit.

## 6. TË ARRITURAT

Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat jemi përballur në vitin 2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka treguar rezultate të knaqshme dhe ka punuar vazhdimisht në drejtim të të përbushjes së detyrimeve të saj ligjore.

Ndër të arriturat kryesore përgjatë këtij viti konsiderohen:

### a) Efikasiteti në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit ekonomik

Sa i përket trajtimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit ekonomik, gjatë kësaj periudhe, prokurorët e angazhuar në Njësitin e Specializuar për trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit ekonomik, kanë treguar një performancë të shkëlqyer duke arritur objektivat e përcaktuara me Strategjinë për luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Të dhënat statistikore do të paraqiten tek fusha e statistikave. Tutje tek pjesa e Njësitit i gjeni edhe arritjet e prokurorëve në hetimin e rasteve për të cilat edhe sot krenohemi.

### b) Fuqizimi i Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion

Duke parë rëndësinë e punës së këtij Njësitit, lëndët e ndërlikuara të cilat këta prokurorë po i trajtojnë, edhe pse me një numër të vogël të stafit mbështetës ( bashkëpunëtorëve profesional) kemi caktuar nga një bashkëpunëtorë profesional me kohë të plotë që të punojë ngushtë me prokurorët të cilët punojnë në këtë njësit, gjithashtu në pjesën e dytë të vitit është rritur edhe numri



i prokurorëve në kuadër të Njësitit ku fillimisht janë angazhuar nëntë (9) prokuror e pastaj nën udhëzimet e KPK-së janë larguar tre (3) prokuror dhe kanë mbetur gjashtë (6).

**c) Fuqizimi i Njësitit për trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje**

Mbështetur në numrin gjithnjë në rritje të rasteve të Dhunës në familje dhe rëndësisë së trajtimit efikas të kësaj dukurie, në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, është themeluar Njësi i veçantë për trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje. Krijimi dhe fuqizimi i këtij njësi të veçantë kishte për synim rritjen e efikasitetit në trajnimin e rasteve të kësaj natyre, duke profilizuar në këtë formë prokurorë të caktuar të merren vetëm me këtë natyrë të lëndëve.

**d) Rritja e efikasitetit tek trajtimi i rasteve me Ndihmë Juridike Ndërkombëtare**

Kujdes të veçantë i është kushtuar rasteve me kërkesa ndërkombëtare, duke ndarë si përgjegjësi shtesë për zyrën e kryeprokurorit që çdo kërkesë e natyrës urgjente dhe të tjera t'u ndihmojë prokurorëve, të njëjtat t'i vë në pah që të trajtohen sa më shpejtë, duke ofruar ndihmë profesionale. Prokuroria Themelore Prishtinë ka të caktuar dy (2) koordinator për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë. Përmes këtij përkushtimi si prokurori kemi pranuar vlerësime pozitive edhe nga Institucionet e tjera.

e) Zyra e Ndërmjetësimit vepron që nga janari i vitit 2018, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e njëjta edhe sot me plot përkushtim është duke ngritur numrin e lëndëve që procedohen përmes kësaj procedure alternative.

Më tutje në takimet e mbajtura me akterë tjerë, kemi pranuar vlerësime pozitive për një përkushtim serioz dhe rritje të numrit të rasteve të përfunduara përmes kësaj procedure.

**e) Bashkëpunim efikas me organet e tjera shtetërore**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, si prokuroria më e madhe në nivel vendi, jemi angazhuar të identifikojmë faktorët e jashtëm që paraqesin vështirësi në procesin e punës. Në këtë kuptim, kemi marrë iniciativë që të mbajmë takime me organet e tjera shtetërore me të cilat kemi bashkëpunim të përditshëm. Këto takime kanë qenë me një profit të lartë për Prokurorinë Themelore në Prishtinë pasi që përmes tyre kemi ngritur koordinimin edhe tejkalimin e sfidave të përbashkëta.

**f) Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve**

Në këtë kuadër, prokurorët e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme, të cilat kanë shërbyer si mundësi për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme profesionale, sfidave aktuale, dhe shkëmbimin e përvojave të ndryshme me prokurorë dhe gjyqtarë të regjioneve të ndryshme brenda Kosovës. Po ashtu, vlen të theksohet që prokurorët kanë qenë pjesëmarrës edhe në disa trajnime dhe punëtori me karakter regional dhe

ndërkombëtar, të cilat po ashtu kanë shërbyer për të parë, diskutuar dhe shkëmbyer praktikat më të mira të luftimit të dukurive negative.

Rëndësi të veçantë iu është kushtuar pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnime, duke kërkuar seriozitet maksimal. Tutje si prokurori jemi angazhuar që përmes trajnimeve të profilizojmë prokurorët ashtu që në trajnimet e temave të Korrupsionit kemi dërguar prokurorët në këtë Njësit, duke vepruar kështu edhe tek rastet e dhunës në familje apo raste të tjera.

#### **g) Trajtimi i rasteve në kohë dhe brenda afateve**

Kryeprokurori edhe në kolegji, por edhe në takime me prokurorët në mënyrë individuale vazhdimisht ka kërkuar që në kopertina të lëndëve të evidentohet koha se kur ndjekja penale do të parashkruhet.

Andaj, sot gjendja në PTH Prishtinë, është e tillë që edhe në këtë vit nuk kemi pasur raste të cilat ju ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale.

#### **h) Rritja e numrit të prokurorëve**

Pas parashtrimit të shumë kërkesave dhe pas pasqyrit të të gjitha sfidave nga ana e Kryeprokurorit, është arritur që të rritet numri i prokurorëve fillimisht me pranimin e pesë (5) prokurorëve të rinjë në DP duke u pasuar pastaj me avancimin e pesë (5) prokurorëve në DKR si dhe avancimin e edhe të katër (4) prokurorëve të tjerë në DKR të cilët janë në fazën e fillimit të punës.

## **7. STATISTIKAT E PËRGJITHSHME PËR VITIN 2023**

Një element i rëndësishëm që pasqyron punën e institucionit janë të dhënat statistikore, përmes të cilave paraqitet pasqyra e lëndëve, duke përfshirë elementet si : lëndëve të trashëguara, lëndëve të pranuar, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve të pazgjidhura apo në që kanë mbetur në proces në fund të periudhës raportuese, duke përfshirë po ashtu edhe të dhëna tjera specifike të kësaj natyre.

### **7.1. PASQYRA E PËRGJITHSHME E LËNDËVE**

Përmes të dhënave të mëposhtme, pasqyrohet gjendja e përgjithshme e lëndëve në vitin 2022, duke përfshirë numrin e lëndëve të bartura, lëndëve të pranuar, lëndëve të zgjidhura si dhe lëndëve të mbetura në proces në fund të periudhës raportuese. Mbi këto baza, ofrohen të dhënat e përgjithshme si më poshtme:

- Lëndë të bartura nga viti 2022 janë **49.532**;
- Lëndë të pranuar gjatë vitit 2023 janë **15.893**;
- Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2023 janë **12.600**;
- Lëndë të pa përfunduar në fund të vitit 2023 janë **52.908**;
- Efikasiteti i përgjithshëm në trajtimin e lëndëve **79.28%**.

Numri më i madh i lëndëve të pakryera është nga kallëzimet penale me kryerës të panjohur të veprave penale (PPP), gjithsejtë 43.389 lëndë.



Grafikon 1: Paraqet të dhënat e përgjithshme statistikore për vitin 2023



## 7.2. MËNYRA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE (SIPAS PERSONAVE)

Në kuadër të mënyrës së zgjidhjes së lëndëve, prokurorët kanë zbatuar dispozitat ligjore dhe, gjithnjë duke marr për bazë respektimin e të drejtave të palëve në procedurë, duke u mbështetur në provat e lëndës dhe rezultatet e veprimeve hetimore kanë ardh në përfundim për mënyrën e zgjidhjes së lëndës

Në këtë kuadër, bazuar në të dhënat që do të paraqitën në vijimë, vërehet që dominon mënyra e zgjidhjes së lëndëve, me Aktakuzë me gjithsejtë **71.31 %**, duke u pasuar më tutje me Hedhjen e kallëzimit penal me **16.88 %**, Pushimin e hetimit me **6.19%** etj.



Grafikoni 3: Paraqet të dhënat për mënyrën e zgjidhjes sipas personave madhor

## 7.3. VENDIMET E GJYKATËS (SIPAS PERSONAVE MADHOR)

Gjithë procesi zhvillimit të veprimeve hetimore dhe grumbullimit të provave, si synim kryesor ka që në fazat e shqyrtimit të procesit gjyqësor, kur lënda është proceduar në gjykatë dhe Prokurori i Shtetit të jetë në gjendje të ofroj fakte dhe mbroj aktet akuzuese pranë Gjykatës, ndërsa personat e akuzuar të dënohen sipas ligjit për veprat penale që iu janë vënë në barrë.

Në këtë kuptim, vërehet një dominim absolut i përqindjes së vendimeve të gjykatës ku janë marrë Aktgjykime dënuese, në masën prej **97.23%**, fakt ky që na jep të drejtën të besojmë që aktet akuzuese të Prokurorit të Shtetit kanë qenë mirë të argumentuara, dhe janë përfaqësuar në mënyrë profesionale nga prokurorët gjatë procesit gjyqësor. Për më tej, kjo po ashtu na bënë të besojmë që Prokurori i Shtetit nuk procedon lëndët në Gjykatë nëse ato nuk janë të bazuara në prova konkrete.



*Grafikoni 4: Paraqet të dhëna për mënyrën dhe vendimet e Gjykatës*


#### 7.4. TË DHËNA KRAHASUESE PËR PERIUDHËN 2013-2023

Me qëllim të ofrimit të të dhënave krahasuese ndër vite, për periudhën 2013-2022, pasqyrohen të dhëna statistikore në këtë periudhë, duke përshkruar grafikun e linjës për lëvizjen së pasqyrës së lëndëve.

Përmes grafikut të linjës, ofrohet një pasqyrë e qartë për procesin trajtimit të lëndëve ndër vite, duke filluar nga viti 2013 e deri në vitin 2022, për shtyllat:

- lëndët e trashëguara;
- lëndët e pranuar;
- lëndët e zgjidhura;
- lëndët e mbetura.





8. Grafikoni 5: Paraqet pasqyrën krahasuese ndër vite 2013-2022

## 7.5. TË DHËNAT STATISTIKORE SIPAS DEPARTAMENTEVE


Në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë funksionojnë tre departamente dhe dy njësi të veçanta në kuadër të këtyre departamenteve. Të dhënat e mëposhtme, paraqesin informata sipas për lëndët e trajtuara sipas departamenteve dhe njësive të veçanta.

### 7.5.1. Departamenti i Krimeve të Rënda

Departamenti i Krimeve të Rënda ka pranuar një numër të konsiderueshëm të lëndëve, siç pasqyrohen edhe përmes të dhënave në formë grafike. Në kuadër të këtij departamenti vërehet një efikasitet i kënaqshëm në trajtimin e lëndëve të natyrës **PP me 183.75 %** dhe lëndët e natyrës **PPN me 91.12 %**.

Përmes grafikunit të mëposhtëm, pasqyrohen të dhënat e përgjithshme për lëndët në Departamentin e Krimeve të Rënda, duke mos përfshirë të dhënat për lëndët në Njësitin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, të dhëna të cilat do të pasqyrohen në grafikun të veçantë.

# Departamenti i Krimeve të Rënda




Grafikoni 7: Paraqet pasqyrën e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda

### 7.5.2. Njësiti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion

Njësiti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion është një njësi e rëndësishme në kuadër të Prokurorisë, e profilizuar për të trajtuar rastet e korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare etj. Ky njësiti është i strukturuar në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda.

Bazuar në të dhënat e pasqyruara, rezulton një efikasitet i kënaqshëm në trajtimin e lëndëve të kësaj natyre, kur dihet kompleksiteti i zgjidhjes së tyre. Në këtë kuptim Njësiti në trajtimin e lëndëve të natyrës PP ka treguar një efikasitet prej **74.82%** në raport me lëndët e pranuar, ndërsa një efikasitet prej **74.73%** të lëndëve të natyrës PPN.

Pasqyra vjetore e rasteve në këtë njësiti paraqitet përmes grafikoneve si më poshtë:



Grafikoni 10: Paraqet pasqyrën e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda- Njësiti




### 7.5.3. Departamenti për të Mitur

Përmes grafikoni të mëposhtëm, pasqyrohen të dhënat e përgjithshme për lëndët në Departamentin për të Mitur, përfshirë të dhënat për lëndët e natyrës PPM dhe PPN-M. Po ashtu në kuadër të këtij departamenti trajtohen edhe lëndët e natyrës PP.I. dhe PP.II. në situatat kur kryes të veprave penal janë persona madhor, ndërsa për shkak të kompetencës së përcaktuar me ligj, trajtohen në kuadër të Departamentit për të Mitur.

Nëse i referohemi të dhënave të paraqitura më poshtë, ky departament ka treguar një performancë të lartë, duke trajtuar lëndët PPM **65.72%**, lëndët PP.I. **74.28%** dhe lëndët PP.II. **76.13%**.

## Departamenti për të Mitur



Grafikoni 8: Paraqet pasqyrën e rasteve në Departamentin për të Mitur


#### 7.5.4. Departamenti i Përgjithshëm

Departamenti i Përgjithshëm si njësi brenda Prokurorisë Themelore Prishtinë ka trajtuar dhe ka punë numrin më të madh të lëndëve në kuadër të Prokurorisë.

Përveç pranimit dhe trajtimit të lëndëve, në kuadër të këtij departamenti prokurorët kanë një angazhim të lartë edhe në pjesëmarrjen e tyre në seanca gjyqësore si dhe pranojnë dhe trajtojnë kërkesa të ndryshme nga palët.

Nëse i referohemi të dhënave statistikore, në kuadër të këtij Departamenti janë trajtuar me prioritet të lartë lëndët e natyrës PP, duke treguar efikasitet prej **89.43 %** duke mos lënë anash edhe lëndët e natyrës PPN me një efikasitet prej **69.20%**.

Përmes grafikontit të mëposhtëm, pasqyrohen të dhënat e përgjithshme për lëndët në Departamentin e Përgjithshëm, përfshirë të dhënat për lëndët e natyrës PP, PPN dhe PPP.



Grafikoni 9: Paraqet pasqyrën e rasteve në Departamentin e Përgjithshëm

## 7.6. PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT

Që nga janari i vitit 2018 në Prokurorinë Themelore në Prishtinë vepron Zyra e Ndërmjetësimit e cila ka edhe zyrtaret që merren vetëm me procedimin e këtyre lëndëve. Për prokurorinë tonë ndërmjetësimi edhe më tej mbetet një alternativë shumë e rëndësishme e cila po mundëson zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve, jep rezultate më të shpejta, ka kosto më të ulët dhe fleksibilitet më të madh, i cili po ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve. Vazhdimisht janë promovuar dhe nxitur prokurorët që të shfytrojnë dhe të zgjedhin rastet me aplikim të procedurave alternative, me fokus të veçantë në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor kemi pasur statistikën si vijon:

- a) Lëndë të pranuar nga zyrat e Prokurorëve (616)
- b) Lëndë të zgjidhura me ndërmjetësimin (556)
- c) Lëndë të përfunduar me ndërmjetësimin (53)
- d) Lëndë në proces në zyrën e ndërmjetësimit (7)
- e) Gjithsejtë persona të përfshirë në lëndët e Ndërmjetësimit (1602)

## 7.7. PEZULLIMI I PËRKOSSHËM I PROCEDURËS

Në bazë të aplikimit të procedurës alternative për vitin 2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka realizuar të ardhura në fondin për kompensimin e viktimave, **në shumën prej € 45,900.00**. Në këtë kuptim vërehet një rritje e konsiderueshme e aplikimit të kësaj procedure, në raport me vitin 2022, ku vlera e përgjithshme e lëshimit të faturave uniref ishte 7.800 euro.

## 7.8. NEGOCIMI I MARRËVESHJES SË PRANIMIT TË FAJËSISË

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur gjithsej 69 marrëveshje për pranim të fajësisë me gjithsej 81 persona.

## 8. KONFISKIMET DHE SEKUESTRIMET

Nga Departamenti i Përgjithshëm kemi pasur total 15 kërkesa për konfiskim dhe sekuestrim.

Nga Departamenti për Krime të Rënda kemi pasur në total 8 kërkesa për konfiskim dhe sekuestrim.



## 9. FINANCAT DHE SHPENZIMET

Shpenzimet e Avokateve dhe Eksperteve			
Nr.	Muaji	Vlera	Verejtje
1	Janar	8,460.00	
2	Shkurt	21,428.22	
3	Mars	22,864.78	
4	Prill	21,686.54	
5	Maj	-	
6	Qershor	20,865.74	
7	Korrik	19,554.80	
8	Gusht	11,595.91	
9	Shtator	42,035.53	
10	Tetor	33,341.49	
11	Nentor	28,763.81	
12	Dhjetor	22,357.16	
	<b>Total 2024</b>	<b>252,953.98</b>	

## 10. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

### 11.1. AKTIVITETET

Gjatë vitit 2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka realizuar aktivitete të ndryshme të cilat janë paraparë me Strategjinë për Komunikim në Sistemin Prokurorial (2021-2023) dhe Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial, të cilat kanë mundësuar të përmirësohet në një shkallë më të lartë komunikimi i brendshëm e deri tek ai i jashtëm, meqenëse gatishmëria për bashkëpunim dhe koordinim të informacioneve nga prokurorët e kësaj prokurorie me kreun e këtij institucioni dhe Zyrën për Informim ka qenë e nivelit më të lartë sesa i viteve paraprake e cila është dëshmuar përmes informatave të dhëna me vetiniciativë nga ky institucion, përgjigjet e ofruara në kërkesat e parashtruara nga subjekte të ndryshme, po ashtu në prononcimet e dhëna për rastet me interes për publikun, përpilimin e komunikatave, aktiviteteve, reagimeve etj.

Në bazë të aktiviteteve të lartcekura përgjatë vitit 2023, ka pasur përpjekje për të përmirësuar cilësinë e komunikimit të sistemit prokurorial në përgjithësi, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës për opinionin e gjerë publik dhe ngritjen e bashkëpunimit me mediat me qëllim informimit të shpejtë dhe të saktë të opinionit lidhur me punën e prokurorisë, si dhe ngritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

#### 11.1.1. RAPORTI 24 ORËSH

Përgjatë kësaj periudhe, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka hartuar në baza ditore raportin 24 orësh në kohë të paraparë dhe i është dërguar Zyrës për Informim në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Raporti 24 orësh ka sjellë rezultat të shkëlqyeshëm në përmirësimin e komunikimit të brendshëm në Prokurorinë Themelore-Prishtinë, duke kontribuar në procesin e punës si element pozitiv, e po ashtu edhe në komunikimin e jashtëm, pasi përmes publikimit të këtij raporti kemi arritur t'i servojme publikut informata lidhur me veprimtarinë 24 orëshe të PTHP-së dhe jo vetëm për opinionin publik, ngase mediat online kanë prodhuar shkrime (lajme) për aktakuzat e ngritura çdo 24 orësh, me theks në aktakuzat e ngritura për rastet e dhunës në familje dhe ato të natyrës korruptive, duke ndikuar krejt kjo në perceptimin pozitiv të opinionit karshi institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe ngritjes së nivelit të besueshmërisë në sistemin prokurorial në përgjithësi.

#### 11.1.2. KËRKESAT PËR INFORMATA

Kërkesat për informata (pyetjet) i kemi pranuar qoftë në emailin e Zyrtares për informim, emailin e prokurorëve apo të emailit zyrtar të Prokurorisë së Prishtinës, megjithatë ka qenë i qasshëm edhe kontakti përmes telefonit, ku si parashtrues të këtyre kërkesave janë të përfshirë kategoria e gazetarëve, shoqëria civile, palët, institucionet e Republikës së Kosovës, mediat ndërkombëtare etj. Përmes këtij aktiviteti parashtruesit e kërkesave janë informuar vazhdimisht për rastet të cilat kanë qenë në interes të tyre dhe në interesin publik, duke mos e përjashtuar Komunikimin proaktiv, pasi në baza të rregullta me vetiniciativë kemi dhënë informata për raste më në interes të publikut, respektivisht gazetarëve të cilët raportojnë dhe e monitorojnë fushën e drejtësisë. Gjatë vitit 2023 kemi pranuar gjithsej 804 pyetje nga subjektet e lartcekura, ndërsa kemi kthyer 661 përgjigje.

#### 11.1.3. KOMUNIKATAT/NJOFTIMET/REAGIMET

Njëri prej objektivave kryesore në Strategjinë për Komunikimin në Sistemin Prokurorial (2021-2023) ka qenë "Komunikimi proaktiv", pra informimi i vazhdueshëm lidhur me punën tonë, ku realizimi i kësaj objektivie është synuar të arrihet përmes disa aktiviteteve, njëri nga to është Avancimi i informimit të rregullt të kryeprokurorëve dhe prokurorëve lidhur me ngjarjet ditore nga fushëveprimtaria e sistemit prokurorial, si dhe Komunikimi efikas dhe efektiv në raste specifike. Përveç përfshirjes së kësaj objektivie në aktivitetin e Raportit 24 orësh dhe përgjigjeve të dhëna, është realizuar po ashtu në hartimin dhe publikimin e komunikatave, njoftimeve e reagimeve të cilat gjatë vitit 2023 janë gjithsej 35. Komunikatat e tilla janë hartuar dhe publikuar tek mediat dhe në ueb faqen e Sistemin Prokurorial, për rastet të cilat kanë qenë në interes të informimit të publikut, përfshirë edhe rastet ku kanë prodhuar kriza, si dhe aktivitetet (takimet) e organizuara nga Kryeprokurori me institucionet relevante apo të ngjashme. Në rastet specifike (të ndjeshme), jemi koordinuar me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në plasimin e informatave, po ashtu, përgjatë këtij viti në disa raste ku janë zhvilluar aksione lidhur me çështje të ndryshme penale kemi bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, për çka kemi publikuar komunikata të përbashkëta me këtë institucion, pa lënë anash komunikatat e përbashkëta dhe me Institutin për Mjekësi Ligjore.

#### 11.1.4. PRONONCIMET

Me qëllim të informimit të vazhdueshëm të opinionit publik dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe transparencës, si dhe me qëllim të avancimit të bashkëpunimit me mediat, viti 2023 ka vazhduar të jetë shembull për institucionin tonë krahasuar me vitet paraprake, pasi roli ynë aktiv në raport me mediat është prezantuar përmes 50 prononcimeve, në të cilat hyjnë paraqitjet (lidhjet) direkte për televizionet vendore, kronika të lajmeve, si dhe dokumentarë, duke iu mundësuar qytetarëve ta shohin më afër (pranë) institucionin e Prokurorit të Shtetit dhe garancinë që ua jep ky institucion qytetarëve për një siguri juridike.

Gjithashtu, përgjatë këtij viti vlen të ceket se Prokuroria Themelore në Prishtinë është prezantuar jashtë kufijve të Kosovës, respektivisht kemi realizuar lidhje direkte për televizionet e Shqipërisë, lidhur me rastet të cilat kanë qenë në interes për publikun shqiptar.

Të gjitha këto prononcime janë zhvilluar nga bashkëpunimi dhe koordinimi i ndërsjellë me prokurorët e rasteve dhe me Kryeprokurorin.

#### 11.1.5. KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Përveç kërkesave për informata të parashtruara nga subjektet e lartcekura, viti 2023 është përcjellur gjithashtu me kërkesat e pranuar për qasje në dokumente publike, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-051 për Qasje në Dokumente Publike, dhe atë me 35 kërkesa të tilla të parashtruara në prokurorinë tonë, prej tyre tri janë refuzuar, ndërkaq kërkesat e tjera kanë marrë përgjigje (iu është lejuar qasja pjesërisht apo në tërësi në dokumente), kryesisht në aktakuza, hudhje të kallëzimeve penale dhe mbyllje të rasteve. Duhet përmendur rolin aktiv që ka pasur Agjencia për Informim dhe Privatësi, pasi në bazë të disa vendimeve të cilat i ka prodhuar kjo Agjenci, neve jemi detyruar t'iu lejojmë qasje në dokumente, për t'iu shmangur dënimeve të tyre (gjobave) drejtuar institucionit tonë.

#### 11.1.6. RRJETET SOCIALE

Risi gjatë këtij viti në fushën e komunikimit ka qenë hapja e rrjeteve sociale dhe mirëmbajtja e tyre, më konkretisht në rrjetin social në "Facebook", është hapur një llogari zyrtare (funpage) i sistemit prokurorial, në të cilën përveç publikimit të aktiviteteve të kësaj prokurorie në ueb faqen ekzistuese kanë qenë të publikuara edhe në këtë llogari, duke arritur lajmi më shpejtë tek përdoruesit e këtij rrjeti social, e po ashtu, këtë vit fushën e komunikimit e ka shoqëruar edhe hapja e kanalit "You Tube" të sistemit prokurorial.

### 11.2. Sfidat në fushën e komunikimit

Viti 2023 është shoqëruar me disa sfida gjatë realizimit të aktiviteteve në fushën e komunikimit në prokurorinë tonë, mirëpo këto sfida duhet të merren si objektiva që synojnë të realizohen gjatë vitit 2024 dhe të punohet në drejtim të përmirësimit të tyre:

- Nevoja për fuqizim të zyrës për informim në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, duke rekrutuar edhe një (1) zyrtar/e shtesë apo më tepër; *(Për faktin se intensiteti i punës në vazhdimësi është tejet i lartë, dhe mundësia për trajtim në kohë reale të kërkesave të ndryshme nga mediat dhe palëve tjera është një sfidë e vërtetë)*

- Mungesa e një salle të konferencave (hapësire) brenda prokurorisë sonë dhe pajisjeve adekuate;
- Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional (*sidomos në raste krizash*);
- Rrjedha e informacioneve;
- Publikimi i informatave në rastet e të miturve;
- Cenimi i të drejtave për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë (*nga raportimet në media*);
- Mungesa e akteve nënligjore të nxjerra nga KPK, lidhur me përdorimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve sociale, si dhe mos përfshirja e zyrtarëve për komunikim me publikun në Rregulloren Nr.03/2023 për Shtesat dhe kompensimet për të punësuarit në sistemin prokurorial.

### 11.3. Raporti për vitin 2023

#### Viti 2023

Pyetjet	Përgjigjet	Komunikatat	Prononcimet	Kërkesat për qasje në dokumente publike	Rrjetet sociale
804	661	35	50	35	

Grafikoni 1. Paraqet në formë statistikore aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 në fushën e komunikimi me publikun

## 11. KËRKESAT PËR FILLIM TË PROCEDURAVE DISIPLINORE PËR PROKURORËT DHE TRAJTIMI I TYRE

Ndër prioritetet kryesore të Kryeprokurorit gjatë këtij viti ka qenë edhe çështja e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve, andaj në cilësi të Autoritetit Kompetent dhe duke vepruar konform dispozitave të *Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*, Nr. 06/L-057 dhe Rregullosës për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve me Nr.05/2019, pasqyrohen të dhënat si në vijim:

- **Ankesat disiplinore të pranuar në vitin 2023:** Autoriteti Kompetent –Kryeprokurori në Prokurorin Themelore në Prishtinë numri i ankesave të pranuar ndaj prokurorëve është gjithsej **tridhjetë e katër (34) Ankesa disiplinore** për periudhën janar- dhjetor 2023.
- **Vendimet për hedhje të ankesave disiplinore:** Gjatë periudhës Vjetore të vitit 2022, pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Autoriteti kompetent ka marr Vendim-Hedhje të ankesave **gjithsej njëzet e tetë (28) ankesa.**

- **Kërkesat për fillimin e procedurave disiplinore:** Numri i kërkesave për fillimin e procedurave disiplinore për periudhën janar- dhjetor 2022 Autoriteti Kompetent ka iniciuar fillimin e procedurës disiplinore **gjithsej për gjashtë ( 6 ) ankesa disiplinore.**
- **Pezullimi i procedurave që janë të pezulluara:** gjatë periudhës vjetore 2022 në Prokurorin Themelore në Prishtinë, Autoriteti Kompetent nuk ka **pezulluar ndonjë procedurë.**
- **Vendimet e Këshillit Prokurorial lidhur me shqiptimin e sanksioneve disiplinore:** Autoriteti Kompetent lidhur me fillimet e procedurave disiplinore që ka iniciuar ndaj prokurorëve përgjatë periudhës janar- dhjetor 2023 ka pranuar **vetëm pesë vendime ( 5 ) vendim** për shqiptimin e masës disiplinore.

## 12. ADMINISTRATA E PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË- STRUKTURA ORGANIZATIVE

Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe funksionimin Prokurorit të Shtetit, përcakton strukturën dhe organizimin e administratës në Prokurorin e Shtetit, përfshirë edhe administratën në prokuroritë themelore.

Bazuar në dispozitat e kësaj Rregullore administrata në Prokurori themelore ka këtë strukturë organizative:

- Administratori;
- Sëktori i Shkrimores;
- Personeli profesional dhe administrativ.

### 13.1. ADMINISTRATORI

Administratori në Prokurorinë Themelore është autoriteti kryesor administrativ, i cili në koordinim me kryeprokurorin menaxhon me funksionet administrative të prokurorisë.

Aktivitetet/proceset e përgjithshme të realizuara në prokurori:

#### 13.1.1. Aktivitetet

- Takime të rregullta të administratorit/es me Kryeprokurorin, udhëheqësit e departamenteve dhe udhëheqësin e Sektorit të Shkrimores,
- Menaxhimi i personelit administrativ të prokurorisë;
- Zbatimi dhe të siguruarit e zbatueshmërisë së rregulloreve për personelin e prokurorisë;
- Caktimi sipas nevojës të personelit administrativ në detyra për të siguruar realizimin e proceseve të punës, me fokus në periudhën punës me staf esencial;
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Këshilli dhe Kryeprokurori i Shtetit;
- Ndërmarrja e veprimeve për ngritjen e efikasitetit të shërbimeve të administratës;
- Mbajtjen e evidencës së prezencës së punës për personelin administrativ;
- Adresimi i ankesave të palëve ndaj të punësuarve në prokurori;
- Vlerësimi i performancës së personelit administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Ndërmarrja e veprimeve që sigurojnë zbatimin e drejtë të Kodit të Mirësjelljes për të punësuarit;
- Pjesëmarrja e administratorit/es në takime dhe aktivitete të ndryshme;
- Pjesëmarrja e administratorit/es në komisione për procedurat e rekrutimit;
- Inventarizimi;

### 13.2. SEKTORI I SHKRIMORES

Spektori i Shkrimores është zyra kryesore ku pranohen, regjistrohen dhe mbahen evidencat për të gjitha lëndët dhe shkresat e Prokurorisë

Struktura organizative e Sektorit të Shkrimores ka këtë formë:


- Udhëheqësi i Sektorit;
- Referentët në Departamentin për Krime të Rënda;
- Referentët në Departamentin për të Mitur;
- Referentët në Departamentin e Përgjithshëm;

#### 13.2.1. Aktivitetet kryesore

Ndër aktivitetet kryesore të zhvilluara në Sektorin e Shkrimores për periudhën raportuese janë:

- Pranimi i lëndëve dhe shkresave tjera;
- Regjistrimi i lëndëve (regjistër dhe SMIL);
- Çregjistrimi i lëndëve në regjistër;
- Janë ofruar shërbime për palë;
- Janë pranuar dhe proceduar aktvendime, aktgjykime dhe shkresa tjera nga gjykata;
- Janë pranuar dhe proceduar ftesat për seanca gjyqësore;
- Janë pranuar dhe proceduar nga gjykata shkresa tjera;
- Janë hartuar raporte të ndryshme, javore, mujore, tre-mujore etj;
- Janë realizuar verifikime të ndryshme;

## Aktivitetet në Sektorin e Shkrimores



- *Grafikoni 15: Parqet të dhënat për aktivitetet kryesore të realizuara nga Sektorin e Shkrimores*

### 13.2.2. Regjistrimi dhe ndarja automatike e lëndëve

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka filluar që nga fillimi i vitit që të realizoj ndarjen automatike të ndarjes së lëndëve sipas sistemit, proces ky i cili nuk ka sjell ndonjë vështirësi, por që në një masë edhe e ka lehtësuar punën në Sektorin e Shkrimores, dhe referentët nuk janë të obliguar të mbajnë dhe realizojnë ndonjë sistem të rrotacionit, i cili ka kërkuar më shumë angazhim dhe kujdes.

### 13.2.3. Zhvillimet aktuale lidhur me zbatimin e Projektit TIK/SMIL.

Sistemi prokurorial, por edhe ai gjyqësor, janë në proces të funksionalizimit të plotë së sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve SMIL. Ky sistem synon që punën manuale të pranimit dhe menaxhimit të rasteve ta zëvendësoj me sistem elektronik, në drejtim të krijimit të kushteve për përsheptimin dhe menaxhimin më efikas të lëndëve në Prokurori.

**Lëndët e reja:** Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka filluar me aplikimin e SMIL që nga 19 nëntori i vitit 2018, dhe të gjitha lëndët e reja të pranuar pas kësaj periudhe pranohen dhe regjistrohen përmes sistemit.

**Ndarja automatike e lëndëve** – në këtë periudhë Prokuroria Themelore Prishtinë ka filluar me zbatimin e ndarjes automatike të lëndëve përmes SMIL.

**Gjenerimi i regjistrave elektronik**- sistemi ka krijuar mundësinë e gjenerimit të disa regjistrave elektronik, proces ky i cili do të vazhdoj edhe vitin e ardhshëm.

**Gjenerimi i raporteve përmes sistemit**- është gjeneruar raporti vjetor nga SMIL dhe krahasimi i të dhënave me raportin fizik paraqet këtë një gjendje të përafërt për lëndët e pranuar (me një dallim me vetëm prej 25 lëndëve), ndërsa lëndët e kryera me një dallim të përafërt prej 400 lëndëve.

#### 13.2.4. Prioritetet, sfidat, të arriturat në Sektorin e Shkrimore

Spektori i Shkrimore si njësi brenda administratës së Prokurorisë, për nga natyra procesin e punës e ka të ndjeshëm, duke shtuar këtu edhe intensitetin e lartë të punës. Mbështetur në këto rrethana, sfidat kanë qenë evidente në këtë sektor.

Kërkesat e vazhdueshme dhe hartimi i vazhdueshëm i shumë raporteve dhe verifikimet e shumta të realizuara, krahas punës primare, kanë sfiduar në masë punën në Sektorin e Shkrimore.

Në konceptin e vendosjes së prioriteteve në realizim të detyrave, është arrit të menaxhohet suksesshëm procesi i përgjithshëm i punës.



Më poshtë, paraqiten prioritetet, sfidat dhe të arriturat kryesore në Sektorin e Shkrimores:

### Prioritetet

Menxhimi i përgjithshëm i procesit të punës;

- Pranimi, regjistrimi dhe procedimi i kallzimeve penale, shkresave nga Gjykata dhe shkresave tjera;
- Fuqizimi i Sektorit të Shkrimores;
- Avancimi i shërbimeve të ofruara;
- Avancimi në SMIL me ndërlidhjes me sistemin e Policisë;
- Ndajra automatike e lëndëve;
- Rritja e stafit

### Sfidat

- Procesi i punës në rrethanat e me kushtet e punës në Pallat- reduktimet e stafit;
- Menaxhimi i procesit të punës në Sektorin e Shkrimores, përfshirë edhe arkivat, si pasojë e intensitetit të lartë të punës
- Stafi jo i mjaftueshëm;
- Kërkesat e vazhdueshme për raporte të ndryshme;
- Realizimi i verifikimeve të shumta për persona të ndryshëm

### Të arriturat

- Menaxhimi i përgjithshëm i procesit të punës në rrethanat e krijuara, fillimisht nga greva e administratës, mandej reduktimet e vazhdueshme të stafit;
- Pranimi, regjistrimi dhe procedimi i lëndëve dhe shkresave tjera në zyrat e prokurorëve;
- Aplikimi i ndarjes automatike të lëndëve;
- Procedimi brenda afateve i lëndëve dhe shkresave

## 13.3. PERSONELI PROFESIONAL DHE ADMINISTRATIV

### *Bashkëpunëtorët profesional*

Përgjegjësitë e bashkëpunëtorëve profesional janë të përcaktuar me rregullore dhe me aktin e përshkrimit të detyrave të punës.

Ndër aktivitetet kryesore të bashkëpunëtorëve profesional ishin:

- Kanë përpiluar draft-autorizime;
- Kanë përpiluar draft-aktvendime të ndryshme;
- Kanë përpiluar draft- aktakuza;
- Kanë përpiluar draft-marrëveshje për pranimin e fajësisë;
- Kanë përpiluar draft-akte plotësim aktakuze;
- Kanë përpiluar draft-kërkesa të ndryshme;
- Kanë përpiluar draft-vendime të ndryshme;

- Kanë përpiluar draft-shënime zyrtare të ndryshme;
- Kanë përpiluar draft- aktvendime për hushje të kallëzimit penal PPP;
- Kanë marr pjesë dhe kanë asistuar prokurorët në seanca;
- Kanë përpiluar draft-masa edukative;

#### **Zyrtarët ligjor**

Përgjegjësitë e Zyrtarëve ligjor janë të përcaktuar me rregullore dhe me aktin e përshkrimit të detyrave të punës.

Ndër aktivitetet kryesore të zyrtarëve ligjor ishin:

- Janë pranuar lëndët për zyrën e prokurorit;
- Janë dorëzuar në shkrimore lëndët e kryera;
- Është ofruar mbështetje me hartim të draft-aktakuza/aktvendime/kërkesa;
- Është ofruar mbështetje me hartim të draft-urdhëresa/autorizime/akte tjera;
- Janë përpiluar procesverbale të marrjes në pyetje;
- Janë përgatitur dhe proceduar ftesat për palë;
- Janë hartuar raporte të ndryshme për zyrën e prokurorit;

#### **Fletë- dorëzuesit**

Ndër aktivitetet kryesore të zyrtarëve për distribuim të shkresave ishin:

- Pranimi dhe procedimi në gjykatë i aktakuzave;
- Pranimi dhe procedimi në gjykatë i aktvendime;
- Pranimi dhe procedimi në gjykatë shkresa tjera;
- Pranimi dhe procedimi i shkresave në institucione tjera;

#### **Buxhet dhe Financa**

- Janë pranuar fatura;
- Janë hartuar kërkesa për zotim të mjeteve;
- Janë hartuar kërkesa për shlyerje të detyrimeve;
- Janë pranuar dhe dorëzuar në SKPK-Dosje për SIMFK;
- Janë lëshuar fatura UNIREF në vlerë;

#### **Teknologjia informative**

Zyrtarët e TI-së kanë ofruar mbështetjen e nevojshme për kërkesat e prokurorëve dhe stafit mbështetës, që ndërliken me fushën e pajisjeve të teknologjisë informative.

Me fokus, në këtë periudhë është tentuar vazhdimisht të fuqizohet përdorimi i platformës Help-Desk, në kuptim të parashtrimit të kërkesave për mbështetje në këtë fushë, përmes këtij aplikacioni.

### **Përkthimi**

Zyra për përkthim ka realizuar aktivitete kryesisht në përkthimin e materialeve të ndryshme sipas nevojave të prokurorëve dhe stafit mbështetës, si dhe ka ofruar shërbimin e përkthimit simulant.

### **Arkivat**

Zyrtarët për arkivë kanë realizuar detyrat e punës sipas përshkrimit të vendit të punës. Ka qenë sfiduese menaxhimi i procesit të punës në periudhën e pandemisë, si rezultat i reduktimeve të vazhdueshme të stafit.

Ndër aktivitetet kryesore kanë qenë:

- Arkivimi i lëndëve;
- Arkivimi i shkresave;
- Pranimi i kërkesës dhe nxjerrja e lëndëve për seancat gjyqësore;
- Pranimi i kërkesës dhe nxjerra e lëndëve pas pranimit të aktgjyqimeve; aktvendimeve apo shkresave tjera;

### **Shërbimet e përgjithshme**

Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme, janë realizuar kryesisht këto aktivitete:

- Furnizimet me material;
- Ofrimi i shërbimeve të vozitjes;
- Shërbimet e mirëmbajtjes;

## 14. PËRFUNDIM

Prokuroria Themelore ne Prishtine, përgjatë vitit 2023 është ballafaquar me sfida të shumta, ndër të cilat mund të përmenden: menaxhimi i proceseve të punës në kushtet e vështira në Pallatin e Drejtësisë; numri i madh i lëndëve të pranuar, të të gjitha natyrave; trajtimi i lëndëve të natyrës krime ekonomike dhe korrupsion; konsolidimi i vazhdueshëm në ndërlidhjen e sistemeve elektronike (SMIL) Polici- Prokurori dhe Prokurori- Gjykatë; numri i madh i lëndëve të natyrës PPP (kryerës të panjohur) dhe trajtimi i tyre; ngritja e nivelit të sigurisë brenda objektit të Prokurorisë.

Megjithatë sfidat e lartpërmendura, dhe kushtet në të cilat kemi punuar të arriturat që në vitin 2023 janë konkrete dhe të prekshme. Trajtimi me fokus i lëndëve të natyrës Dhunë në familje, Veprat penale kundër integritet seksual, luftimi i krimeve ekonomike dhe korrupsionit, promovimi dhe aplikimi i procedurave alternative, menaxhimi me procesin e punës me staf esencjal ishin vetëm disa nga të arriturat më konkrete në këtë periudhë.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, mbetet e përkushtuar që edhe në vitin 2024, të punoj fuqishëm në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj, duke tentuar në këtë formë të përballoj numrin e madh të lëndëve të pranuar, dhe të zvogëloj numrin e atyre të trashëguara. Në këtë kuadër, plotësimi i vendeve të punës me prokurorë dhe staf mbështetës, do të jetë një ndihmës shtesë për Prokurorinë në arritjen e rezultateve edhe më të mëdha gjate kësaj periudhe.

Prokuroria Themelore në Prishtinë do të ofroj kontributin e saj edhe në proceset e përgjithshme të punës të cilat zhvillen në sistemin prokurorial, duke vënë në dispozicion gjithë kapacitetet e saj njerëzore dhe profesionale në angazhime në punëtori të ndryshme, grupe punuese, komisione rekrutimi dhe procese tjera të kësaj natyre.